



Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë

PYETËSORI PËR KONGRESIN E XVIII-TË TË KONFERENCËS SË GJYKATAVE KUSHTETUESE EUROPIANE

TË DREJTAT DHE LIRITË THEMELORE TË NJERIUT: MARRËDHËNIA E KATALOGËVE KOMBËTARË, SUPRAKOMBËTARË DHE NDËRKOMBËTARË NË SHEKULLIN E 21-TË

I. PJESA E PËRGJITHSHME: KATALOGËT E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT

II Katalogët ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut (KEDNJ, DUDNJ, TNDCP)

- Në vendin tuaj, cili është pozicioni kushtetues/karakteristika/forca ligjore e traktateve ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut?

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë evidentohet rëndësia që paraqesin për të drejtën tonë të brendshme marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat shteti shqiptar është palë dhe që i ka pranuar dhe ratifikuar. Sipas nenit 5 të Kushtetutës “Shqipëria zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”. Në nenin 116 është parashikuar hierarkia e akteve normative, të cilat kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, ku marrëveshjet ndërkombëtare radhiten në këtë klasifikim menjëherë pas Kushtetutës dhe përpara ligjeve dhe akteve të tjera normative të Këshillit të Ministrave. Në nenin 122 të Kushtetutës parashikohet se “çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare dhe “një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”.

Kushtetuta, duke pranuar epërsinë e së drejtës ndërkombëtare, nuk është mjaftuar vetëm me këto formulime, por ka guxuar t’i japë një pozitë krejt të veçantë Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke e renditur në të njëjtin nivel. Ky pozicion i veçantë i Konventës Europiane në raport me vetë Kushtetutën, me marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me ligjet e vendit, pasqyrohet në nenin 17, pika 2 e Kushtetutës në të cilin parashikohet se “këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut”.

- Cili është mekanizmi që përdoret për referimin e traktateve ndërkombëtare gjatë procesit vendim-marrës të gjykatave kombëtare?

Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i vendosin marrëveshjet ndërkombëtare pas Kushtetutës dhe i konsiderojnë si pjesë e sistemit të brendshëm juridik, si dhe parashikojnë zbatimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për më tepër me një lloj epërsie mbi legjislacionin vendas kur nuk pajtohet me to.

Konventa Europiane ka një status supra-ligjor dhe nën-kushtetues sepse sipas nenit 116 të Kushtetutës renditet mbi ligjet dhe pas Kushtetutës. Për shkak të këtij statusi që ka marrë Konventa në rendin e brendshëm juridik, çdokush mund të paraqesë një ankim në Gjykatën Kushtetuese ose dhe në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për mbrojtjen e të drejtave individuale, duke iu referuar drejtpërdrejtë dispozitave të saj.

Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 17/2 të Kushtetutës, në jurisprudencën e saj thekson se teksti i konventës, i këtij akti juridik të të drejtës ndërkombëtare, shërben si një instrument në duart e gjyqtarëve, i cili i ndihmon ata të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore të sanksionuara në Kushtetutë sipas frymës së Konventës. Natyrisht kjo kërkon një njohje të mirë dhe një familjarizim të gjyqtarëve me Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut, për ta përdorur atë gjatë veprimtarisë së tyre të interpretimit/zbatimit të ligjit.

Gjykata Kushtetuese në lidhje me trajtimin e të drejtave themelore të njeriut në jurisprudencën e saj është shprehur se: “GJEDNJ ka në sistemin tonë juridik një kompetencë ekskluzive. Kjo kompetencë është pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik, për efekt të zbatimit të nenit 122 të Kushtetutës po edhe nenit 17, pika 2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ zbatohen drejtpërsëdrejti” (vendimin nr. 20, datë 01.06.2011). Kjo është edhe arsyeja që Gjykata Kushtetuese, në mënyrë të vazhdueshme në jurisprudencën e saj, u referohet vendimeve të Gjykatës Europiane, duke pranuar efektin e drejtpërdrejtë të tyre në interpretimin e standardeve kushtetuese për të drejtat e njeriut.

- A është i mundur referimi i efektit të drejtpërdrejtë të katalogëve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut? Nëse po, ju lutemi shpjegoni mekanizmin.

Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës dhe epërsia që ajo merr mbi ligjet, të cilat nuk pajtohen me të, e drejta e Gjykatës Kushtetuese për të shqyrtuar pajtueshmërinë e ligjeve jo vetëm me Kushtetutën por edhe me marrëveshjet ndërkombëtare si dhe vendosja e një standardi minimal që nuk lejon tejkalimin e kufizimeve të parashikuara në Konventë, i kanë dhënë asaj pozicion *quasi-kushtetues*.

Gjykata Kushtetuese ka zbatuar për herë të parë nenin 17/2 të Kushtetutës, me rastin e shfuqizimit të dënimit me vdekje në Republikën e Shqipërisë, parashikuar nga legjislacioni penal. Me vendimin nr. 65/1999 ajo interpretoi të drejtën për jetën të sanksionuar nga Kushtetuta nën dritën e Konventës Evropiane dhe jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut.

Ndërsa, për sa i takon qëndrimin të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me pozicionin e KEDNJ në rendin e brendshëm juridik, duhet theksuar se nuk ka qenë shumë i ndryshueshëm. Kështu, fillimisht, në vendimin nr. 6/2006 ajo i njeht Konventës fuqi mbi-ligjore, por jo mbi Kushtetutën, njësoj si për çdo marrëveshje të ratifikuar me ligj: *Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës.*

Më pas, me vendimin nr. 9/2010 ajo ndryshon qëndrim dhe bën një hap përpara, duke iu referuar edhe standardeve të KEDNJ: *Kushtetua, nëpërmjet referimit të KEDNJ, i ka dhënë këtij dokumenti vlerën e standardit kushtetues për sa i përket kufizimit të të drejtave të njeriut*. Me këtë vendim, Gjykata Kushtetuese bashkohet plotësisht me qëndrimin doktrinor, duke i njohur vetë Konventës si akt, vlerën e standardit kushtetues vetëm sa i takon kufizimit të të drejtave të njeriut.

Duke iu referuar vendimit nr. 20/2011, arrijmë në përfundimin se, për sa i takon vendimeve të GJEDNJ të dhëna me palë Shtetin shqiptar, ato kanë fuqi të detyrueshme dhe zbatohen drejtpërsëdrejti nga ana e gjykatave kombëtare. Ndërsa për vendimet e tjera të GJEDNJ, Gjykata Kushtetuese u njeh një fuqi orientuese, e cila ndihmon gjyqtarët kombëtarë të interpretojnë të drejtën e brendshme në përputhje me Konventën dhe me jurisprudencën e GJENDJ, duke pranuar plotësisht autoritetin ekskluziv që kjo ka në interpretimin e Konventës.

Nisur nga qasja e Kushtetutës sonë në lidhje me të drejtën konventore, ku u njeh marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara me ligj epërsinë mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to, si edhe në sajë të teorisë moniste të përfaquar nga Kushtetuta jonë, evidentojmë se Konventa Evropiane duhet të zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejt nga të gjithë gjyqtarët kombëtarë sa herë që ligjet nuk pajtohen me të. Respektimi i Konventës Evropiane dhe i standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm për Gjykatën Kushtetuese, por dhe për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe në mënyrë të veçantë i Gjykatës së Lartë, për shkak të kompetencës së saj për të rishikuar vendimet gjyqësore, por edhe për të njehsuar praktikën gjyqësore.

I.II Katalogët suprakombëtarë të të drejtave të njeriut (Karta)

Vendi ynë nuk është anëtar i BE-së dhe gjykata jonë nuk zbaton Kartën apo jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

- A shërben Karta si një pikë referimi për kontrollin e kushtetutshmërisë së normave ligjore dhe/ose vendimeve të autoriteteve publike, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë (një pikë formale referimi në disa shtete anëtare të BE-së), qoftë në mënyrë indirekte nëpërmjet “rrezatimit” përmes katalogëve kombëtarë (një pikë substantive referimi në shtetet e tjera)?
- A shërben jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian si udhëheqje për interpretimin dhe zbatimin e katalogëve kombëtarë në vendin tuaj nga gjykatat e zakonshme, apo si burim për ligjbërjen gjyqësore?
- A kushtëzohet në terma kushtetues ndikimi kombëtar i Kartës nga shkalla ekuivalente e mbrojtjes që ofrohet/mundësohet, apo sikurse mund të jetë rasti në shtetet anëtare të BE-së, nga bërja e një kërkesë në Gjykatën e Drejtësisë të BE-së për një vendim paraprak?

I.III Katalogët kombëtarë të të drejtave të njeriut

- A është katalogu i të drejtave të njeriut pjesë përbërëse e kushtetutës në vendin tuaj? Nëse po, si është i përfshirë (si kartë kushtetuese e veçantë, si pjesë e Kushtetutës, pjesë e rendit kushtetues)? Cila është struktura e tij?

Arritja më e madhe e Kushtetutës 1998 qëndron në rregullimin e saj modern e të kujdesshëm të normave ligjore e institucionale në nivel kushtetues, e veçanërisht të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të vendosura në Pjesën II, menjëherë pas Parimeve Themelore shtet-

formuese. Ndërmjet vlerave që shpall Kushtetuta e vitit 1998, më e para është theksuar në Preambulën hyrëse si vendosmëri e Popullit të Shqipërisë “... për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ... me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor...”

Cila është struktura e tij?

Kushtetuta parashikon njohjen, garantimin dhe mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të njeriut, si dhe parashikon një klasifikim interesant dhe domethënës të kategorive të të drejtave dhe lirive themelore: liritë dhe të drejtat vetjake (Kreu II), liritë dhe të drejtat politike (Kreu III), liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale e kulturore (Kreu IV). Kushtetuta shqiptare karakterizohet edhe nga disa elementë të tjerë, që afirmojnë qartësisht frymën e saj moderne dhe inovative: prezencën e një Kreu V të titulluar “Objektivat Socialë”, të një Kreu VI ku përcaktohet ngritja dhe funksionimi i Avokatit të Popullit, si dhe inkorporimi i “Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut” si pjesë integrale të saj, me vlerë e rang *quasi*-kushtetues.

- Cili është kuadri historik i krijimit të katalogut kombëtar të të drejtave të njeriut në vendin tuaj?

Në historinë tonë të së drejtës kushtetuese, edhe akte të tjerë kushtetues nga themelimi i Shtetit e deri në vendosjen e demokracisë pas viteve 90 gjithashtu kanë parashikuar rregullime mbi të drejtat dhe liritë e njeriut por, këto parashikime nuk respektoheshin pasi në sistemin diktatorial mbeteshin të pazbatueshme. I supozuari “katalog i të drejtave të njeriut” i parashikuar nga Kushtetuta e 1976, titullohet njësoj si edhe homologu i tij në Kushtetutën e 1946: “Të Drejtat dhe Detyrat e Shtetasve”, duke mbajtur sërish të njëjtin vlerësim barazues si për të drejtat ashtu edhe për detyrat. vërtet që Kushtetuta 1976 përmbante (gjithaq në mënyrë formale) një katalog të të drejtave të njeriut, madje edhe me ndonjë përmbajtje që tek-tuk kujton formula të njohura të përdorura në kushtetutat liberal-demokrate por, parimet e përgjithshme të vendosura në Kreun I të saj (“Rendi Shoqëror”) përbënin *de facto* dhe *de jure* kufizime absolute për realizimin e këtyre të drejtave, arsye këto që i jepnin karakter fiktiv kësaj kushtetute.

Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese i vitit 1991, fillimisht, nuk parashikonte një katalog të lirive dhe të drejtave të njeriut. Arsyeja kryesore për këtë boshllëk në kartën e parë kushtetuese shqiptare pas rënies së diktaturës ishte sa pamjaftueshmëria e kohës, në një periudhë historike ku ngjarjet zhvilloheshin me shpejtësi, aq edhe mungesa e eksperiencës dhe e njohjes nga ana e juristëve vendas të teorisë dhe praktikës së të drejtave të njeriut. Pothuajse dy vjet më pas, Dispozitat Kryesore Kushtetuese, pasi iu ishin nënshtruar më herët edhe pesë ndryshimeve të tjera, u plotësuan edhe me Kreun e veçantë “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”.

Katalogu i të drejtave të njeriut në Ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese (LDKK) është një Kre më vete, dhe përbëhet nga 41 nene, duke përshtatur një qasje që nuk e fsheh ngjashmërinë me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Njësoj si kjo e fundit, katalogu rendit një numër të drejtash personale, civile, për të vijuar me të drejtat politike e, në fund, mbyllet me disa të drejta social-ekonomike.

Kushtetuta e vitit 1998 parashikon njohjen, garantimin dhe mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të njeriut, kushtetuta adopton një klasifikim interesant dhe domethënës të kategorive të të drejtave dhe lirive themelore: “liritë dhe të drejtat vetjake” (Kreu II), “liritë dhe të drejtat politike” (Kreu III) dhe “liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale e kulturore” (Kreu IV). Kushtetuta shqiptare karakterizohet edhe nga disa elemente të tjera, që afirmojnë qartësisht frymën e saj moderne e inovative: prezencën e një Kreu V të titulluar “Objektivat Socialë”, të një Kreu VI ku përcaktohet ngritja dhe funksionimi i Avokatit të Popullit, si dhe inkorporimi i “Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut” si pjesë integrale të saj, me vlerë e rang quasi-kushtetues.

A është i bazuar legjislacioni përkatës i vendit tuaj në legjislacione të tjera (legjislacion i mëparshëm ose i huaj), apo është origjinal?

Legjislatori kushtetues shqiptar, nën shembullin e Ligjit Bazë të RFGj, Kushtetutës italiane apo asaj Polake, të cilat atëkohë i shërbyen edhe si pika referimi, zgjodhi që të sendërtonte një listë të gjatë e të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Kushtetutë. Qasja shqiptare reflekton edhe dëshirën e një shoqërie, të drejtat dhe liritë e anëtarëve të së cilës ishin mohuar deri në ekstrem përgjatë dekadave të tëra sundimi diktatorial e cila rezultoi në jetë jo thjesht moderne e perëndimore, por mbi të gjitha efikase. Akoma më tej, një katalog kombëtar me një përmbajtje të gjerë të drejtash e lirish individuale, që nis nga ato me karakter vetjak (civil), për të vijuar me ato me karakter politik e për t’u mbyllur me të drejtat dhe liritë ekonomike, sociale e kulturore është edhe tregues i qartë i ndikimit frymëzues të katalogut të madh ndërkombëtar të të drejtave dhe lirive individuale (*alias* The International Bill of Human Rights). “Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut 1948, si edhe dokumente të tjerë të OKB, OSBE (atëkohë KSBE) dhe të Këshillit të Europës që, së bashku, përfaqësojnë katalogun ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, shërbyen si “projekt” për ndërtimin e sistemit të ri”. Këtij “projekti” i detyrohet edhe klasifikimi i të drejtave dhe lirive themelore në Kushtetutën 1998, i cili merr parasysh sa karakteristikat e vetë të drejtave e lirive, aq edhe praktikën ndërkombëtare.

- Cili ka qenë zhvillimi i katalogut kombëtar të të drejtave të njeriut në vendin tuaj me kalimin e viteve? A ka pasur ndryshime? A janë përfshirë në këtë katalog të drejta të reja? A ekziston ndonjë procedurë kushtetuese për modifikimin apo ndryshimin e tij?

Katalogu i të drejtave dhe lirive i parashikuar në Kushtetutën e vitit 1998 përveç disa elementëve që i takojnë teknikës legjislative (draftimit), të tilla si klasifikimi dhe një strukturim më i saktë i rregullimeve të lidhura ndërmjet tyre –nëse i referohemi përmbajtjes, nuk prezanton ndonjë element të ri që meriton të theksohet në krahasim me dispozitat homologe të katalogut të lirive e të drejtave themelore në Ligjin për Dispozitat Kryesore Kushtetuese (LDKK) të vitit 1991.

A ka pasur ndryshime?

Kushtetuta shqiptare në nenin 45, paragrafi 1, parashikon se çdo shtetas që ka mbushur 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, duke i qëndruar besnik sa traditës kushtetuese e shtetformuese kombëtare, aq edhe konsensusit global mbi këtë çështje.

Paragrafi 3 është edhe ndryshimi i parë e i vetëm (deri tani) i një norme kushtetuese të katalogut të të drejtave e lirive themelore. Në kuadër të procesit të garantimit të integritetit të

personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike (dekriminalizimit), u konsiderua e nevojshme nga legjislatori kushtetues zvogëlimi i mëtejshëm i hapësirës së mbrojtur nga rregulli(mi) i parashikuar në paragrafin 1 të nenit 45.

Sipas ndryshimeve: “Përrjashtohen nga e drejta për t’u zgjedhur shtetasit që janë dënuar me burgim, me vendim përfundimtar të formës së prerë, për kryerjen e një krimi, sipas rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në raste përjashtimore dhe të justifikuara, ligji mund të parashikojë kufizime të së drejtës për të zgjedhur të shtetasve që vuajnë dënimin me heqje lirie, ose të së drejtës për t’u zgjedhur para dhënies së një vendimi përfundimtar apo kur shtetasit janë dënuar për një krim ose për cenim shumë të rëndë dhe serioz të sigurisë publike.”

Rregullimi i mëparshëm i këtij neni përjashtonte nga e drejta pasive e votës (vetëm) shtetasit që, në ditën e zgjedhjeve ishin duke vuajtur dënimin e heqjes së lirisë. Rregullimi i ri e zgjeron hapësirën e kufizimit (duke ngushtuar atë të së drejtës) duke përfshirë edhe shtetas të tjerë, të dënuar më herët, që në ditën e zgjedhjeve e kanë përfunduar dënimin. Hollësitë e mëtejshme kushtetutë-bërësi ia ka lejuar t’i parashikojë legjislatori, por vetëm përmes një ligji të përforcuar.

A ekziston ndonjë procedurë kushtetuese për modifikimin apo ndryshimin e tij?

Kushtetuta shqiptare, në nenin 177 të saj parashikon procedurën e rishikimit të vetvetes. Ndryshe nga sa ndodh me aktet e zakonshme të legjislativit, nisma për ndryshimin (rishikimin) e Kushtetutës mund të ndërmerret vetëm nga një e pesta e deputetëve, ndërsa projekti i paraqitur miratohet vetëm me votën “pro” të dy të tretave të tyre. Në çdo rast, projekti mund të kalojë drejtpërdrejt në referendum, nëse po i njëjti numër deputetësh vendos kështu. Në rastin kur miratohet nga Kuvendi, amendamenti kushtetues i nënshtrohet referendumit kur këtë e kërkon një e pesta e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Formula për rishikimin e Kushtetutës 1998, siguron ruajtjen e themelit mbi të cilin qëndron kushtetuta, e që konsiston në marrëveshjen e madhe të strukturave kryesore të shoqërisë, të përfaqësuara nga deputetët e zgjedhur në parlament. Në këtë mënyrë, Kushtetuta 1998 bëhet një strehë e fortë për të drejtat dhe liritë themelore të individit të parashikuara prej saj. Parashikimi i nenit 177/2 se “Asnjë rishikim i Kushtetutës nuk mund të ndërmerret gjatë kohës kur janë vendosur masat e jashtëzakonshme”, e përforcon edhe më shumë këtë konstatim.

I.IV Marrëdhënia reciproke ndërmjet katalogëve të ndryshëm të të drejtave të njeriut

- A mund të jepni shembuj nga jurisprudenca e gjykatës suaj që kanë të bëjnë me përdorimin e ndonjë katalogu ndërkombëtar?

Në vendimin nr. 3, datë 11.02.2004 Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi çështjen, u shpreh: “Ndalimi i torturës në kuadrin e sanksionimit të të drejtave të tjera të njeriut në aktet

ndërkombëtare përbën një garanci për qytetarët jo vetëm ndaj abuzimeve shtetërore, por edhe ndaj abuzimeve të individëve. Qëllimi i dispozitave që ndalojnë përdorimin e torturës është mbrojtja e dinjitetit dhe integritetit fizike mendor të individit. [...]. Për sa kohë që ndalimi i torturës dhe keqtrajtimi është përcaktuar si një e drejtë njerëzore dhe përderisa të drejtat e njeriut janë konsideruar si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme, çdo njeri ka të drejtë për të mos iu nënshtruar torturës apo keqtrajttimeve, pavarësisht nëse ai është në duart e një zyrtari publik apo të një individit. Detyrimi i shteteve palë në marrëveshjet ndërkombëtare për të respektuar e siguruar ndalimin e torturës dhe keqtrajtimit konsiston jo vetëm në detyrimin e shtetit për të mbrojtur shtetasit e tij nga kryerja e torturës apo keqtrajtimit nga zyrtarët publikë, por edhe në detyrimin për të marrë masa për t'i mbrojtur njerëzit ndaj akteve të torturës apo keqtrajtimit të kryer edhe nga individë.”

Në lidhje me garantimin e të drejtës për një ankim efektiv nga Kushtetuta dhe KEDNJ dhe nga akte të tjera ndërkombëtare Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 15 datë 17.04.2003, shtron para organit ligjvënës detyrën që jo vetëm të mos e pengojë individin të ushtroj një të drejtë të tillë, por ti sigurojë atij mjetet e nevojshme për ushtrimin efektiv të saj.

Gjykata Kushtetuese shprehet se: *Në nenin 8 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut si dhe në nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashikohet e drejta e rekursit efektiv ndaj vendimit të gjykatës. Kurse në nenin 2 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile e Politike, përcaktohet për shtetet detyrimi që të garantojnë nëpërmjet organeve kompetente gjyqësore, administrative ose legjislative të drejtën e individit për të ushtruar rekurs si dhe krijimin e mundësive për gjykimin e këtij rekursi”.*

Edhe në Vendimin nr. 32 datë 24.11.2003 GJK shprehet se: *“Mënjanimi në mënyrë arbitrare i kësaj kompetence të organeve gjyqësore në shqyrtimin e ankimeve ndaj ligjshmërisë së akteve të administratës publike, vështirëson ose bën të pamundur efektivitetin e ankimit, kërkesë thelbësore që buron nga neni 13 i Konventës dhe nga neni 8 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”.*

- A e ka marrë në konsideratë gjykata juaj marrëdhënien/hierarkinë/konkurrimin e katalogëve të të drejtave të njeriut në këndvështrimin e mbrojtjes që ato ofrojnë/mundësojnë?

Jo pasi Shqipëria nuk ka detyrimin e aplikimit të Kartës së BE-së ndaj i referohet vetëm KEDNJ-së si pjesë përbërëse e sistemit të brendshëm juridik.

- A ka ndonjë procedurë të përcaktuar për zgjedhjen e një katalogu specifik të të drejtave të njeriut në rastet kur e drejta mbrohet nga më shumë se një katalog (Aplikimi i Kartës është i detyrueshëm për shtetet anëtare të BE-së në përputhje me Nenin 51(1), d.m.th. zbatimi i saj nuk është diskrecional.
N/A

II. PJESA E POSAÇME – ÇËSHTJE SPECIFIKE QË LIDHEN ME TË DREJTA THEMELORE TË PËRZGJEDHURA

II.I E drejta e jetës

- **Cili është formulimi origjinal i dispozitës që mbrohet këtë të drejtë në katalogun tuaj kombëtar?**

KREU II

LIRITË DHE TË DREJTAT VETJAKE

Neni 21

Jeta e personit mbrohet me ligj.

- **A është i mundur kufizimi i kësaj të drejte? Nëse po, si dhe në çfarë rrethanash?**

Për sa i përket kufizimit të të drejtave të njeriut në përgjithësi, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i referohet drejtpërdrejt Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në nenin 17 të saj kur thotë: “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Në rastin e të drejtës së jetës, ajo nuk mund të kufizohet në asnjë rrethanë. Me ligjin Nr.9722, datë 30.4.2007, u hoq dënimi me vdekje edhe nga Kodi Penal Ushtarak, i cili parashikonte këtë dënim për veprat penale të rënda të kryera në kohë lufte.

- **A e ka marrë gjykata juaj në konsideratë këtë të drejtë/interpretimin apo mishërimin e saj në mënyrë më të detajuar? Nëse po, ju lutem jepni detaje praktike dhe listoni katalogët e aplikuar të të drejtave të njeriut.**

Me vendimin nr.65, datë 10.12.1999 Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të dënimit me vdekje, në kohë paqej, të parashikuar në 16 dispozita të Kodit Penal. Pas aderimit në Statutin e Këshillit të Evropës, Shqipëria kishte detyrim të ratifikonte Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut së bashku me Protokollin e saj. Me qëllim përmbushjen formalisht të detyrimit të Shqipërisë për të hequr dënimin me vdekje, u vu në lëvizje Gjykata Kushtetuese. Gjykata e trajtoi këtë çështje nën frymën e KEDNJ-së si më poshtë:

“...Parimet themelore të mbrojtjes së jetës njerëzore gjejnë mbështetje të plotë në dispozitat kushtetuese. Jeta është një e drejtë, atribut fundamental i qenies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet, apo merret nga shteti, njeriu në të njëjtën kohë eliminohet, si bartës të drejtash dhe detyrimesh. Jeta njerëzore përbën një vlerë të padiskutueshme dhe është objekt i mbrojtjes kushtetuese, por kjo nuk do të thotë se mbrojtja e jetës së njeriut në çdo moment dhe në të gjitha rrethanat duhet të jetë e njëjtë, pasi ajo është e influencuar nga një numër faktorësh të natyrave të ndryshme, të cilat është ligjvënësi ai që i parashikon me ligj. Legjislatori është vetëm i autorizuar që të bëjë përjashtimet me ligj, kur si rrjedhojë e mbrojtjes së një të drejte më të rëndësishme kushtetuese, kërkohet të hiqet jeta e dikujt.

... I analizuar sipas frymës së Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dënimi me vdekje është i papajtueshëm me thelbin e këtyre të drejtave dhe lirive. Ai është një mohim i të drejtës për jetën, që shteti e realizon nëpërmjet pushtetit të tij gjyqësor. Dënimi kapital nuk lidhet me kufizimin, por me eliminimin përfundimisht të subjektit nga shoqëria.

Pra, kufizimet që vendos Kushtetuta, sipas paragrafit të parë të nenit 17 duhen kuptuar vetëm për ato raste kur ligjvënësit i njihet e drejta të parashikojë edhe kufizimin e të drejtës së jetës për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke mos nënkuptuar heqjen e jetës, nëpërmjet një vendimi gjyqësor, pasi dënimi me vdekje i zbatuar nga gjykata, nuk është as përjashtim dhe as kufizim që lejohet nga Kushtetuta.

Dënimi me vdekje nuk i përgjigjet as qëllimit të dënimit penal, i cili përfshin shumë momente të rëndësishme që përgjithësisht ndikojnë tek i dënuari, siç janë riedukimi, izolimi, përpjekja për integrimin e tij në shoqëri etj. Masat e tjera penale që përmban Kodi Penal, duke filluar nga gjoba, burgimi deri në 25 vjet, apo burgimi i përjetshëm, si një alternativë e dënimit me vdekje, janë plotësisht të mjaftueshme, të cilat jo vetëm që përmbushin më mirë qëllimet e dënimit penal, por kur ato zbatohen me rigorozitet nga organet gjyqësore, ushtrojnë ndikimin e padiskutueshëm për ndëshkimin e fajtorëve dhe për një luftë efektive kundër kriminalitetit. Ekzistenca e kriminalitetit në këtë shkallë që është sot, si dhe lufta për pakësimin e vazhdueshëm të tij, nuk janë të lidhura në mënyrë të pandashme me prezencën e dënimit me vdekje, se sa me faktin e dobësive që vërehen ende në veprimtarinë e organeve përkatëse në aspektin e zbulimit të veprave penale, të kapjes dhe vënies përpara përgjegjësisë të autorëve, si dhe të aplikimit të dënimeve të përshtatshme ndaj tyre. Shpesh herë presioni që bëhet për ruajtjen e dënimit me vdekje, përveç qëllimeve propagandistike, përdoret edhe si një justifikim për mbulimin e dobësive të organeve të specializuara dhe të punës së pamjaftueshme të shoqërisë për eliminimin e shkaqeve sociale të kriminalitetit.

Dispozitat e Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë që parashikojnë dënimin me vdekje nuk i përmbahen frymës së Kushtetutës dhe cenojnë përmbajtjen thelbësore të të drejtës për jetën dhe dinjitetin njerëzor. Ato dispozita të Kodit Penal që e privojnë jetën e njeriut përbëjnë në vetvete një eliminim të plotë dhe të pakthyeshëm të jetës dhe dinjitetit njerëzor. Ekzekutimi i dënimit me vdekje i kryer ndaj një individi konkret, si rrjedhojë qoftë edhe e një gabimi subjektiv bëhet i pakorrigjueshëm për të dhe si i tillë individi bëhet padrejtësisht viktimë e këtij gabimi.

Duke e analizuar këtë dispozitë kushtetuese lidhur me çështjen në shqyrtim del se kufizimet në të drejtën për jetën, siç është rasti i dënimit me vdekje nuk mund të bëhet, sepse në këtë rast jo vetëm që cenohet, por mohohet tërësisht thelbi i saj. Nga ana tjetër kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane *për të Drejtat e Njeriut nuk kanë të bëjnë me dënimin me vdekje si lloj dënimi penal*“.

- **A ka ndonjë ndryshim ndërmjet jurisprudencës së gjykatës suaj dhe jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte?**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka ndjekur dhe referuar jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte si dhe është bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II.II Liria e shprehjes

- **Cili është formulimi original i dispozitës që mbron këtë të drejtë në katalogun tuaj kombëtar?**

Neni 22

1. Liria e shprehjes është e garantuar.
2. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar.
3. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet.
4. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.

- **A është i mundur kufizimi i kësaj të drejte? Nëse po, si dhe në çfarë rrethanash?**

Liria e shprehjes e parashikuar në Kushtetutë mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj dhe që sjellin përgjegjësi. Një rast i tillë është neni 120 i Kodit Penal i cili parashikon se: “Përhapja e qëllimshme e thënieve, si dhe çdo informacion tjetër që dihet se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjitetin e personit, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.”

Gjithashtu në Kushtetutë parashikohet se: 1. Deputeti nuk mban përgjegjësi për mendimet e shprehura në Kuvend dhe votat e dhëna prej tij në ushtrim të funksionit. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastin e shpifjes. (neni 73)

Për sa i përket elementit liri e shtypit neni 22/3 i Kushtetutës ndalon censurën paraprake të mjeteve të komunikimit, pra thelbi i kësaj lirie qëndron në lirinë absolute nga censura paraprake. Forma e kufizimit të lirisë së shtypit është masa shtrënguese e sekuestrimit, masë e cila zbatohet në rastet kur punimi është botuar dhe ka si qëllim ndalimin e përhapjes së tij.

Për sa i përket lirisë së mediave elektronike kjo është një e drejtë që zbatohet nëpërmjet kuadrit ligjor, pra është ligjvënësi ai të cilit i takon të vendosë kufizimet dhe deri ku shtrihet liria e komunikimit duke mbajtur parasysh kushtet teknike të mjeteve të komunikimit (22/4 i Kushtetutës). Kërkesa për dhënien e licencës sipas kritereve të përcaktuara në ligj është kufizimi që i bëhet lirisë së mediave elektronike dhe kjo për shkak të mënjanimin të pozitës dominuese që krijohet në këtë fushë

- **A e ka marrë gjykata juaj në konsideratë këtë të drejtë/interpretimin apo mishërimin e saj në mënyrë më të detajuar? Nëse po, ju lutem jepni detaje praktike dhe listoni katalogët e aplikuar të të drejtave të njeriut.**

Gjykata Kushtetuese e ka trajtuar lirinë e shprehjes në vendimet e mëposhtme:

Në Vendim nr.16/2004, GJK është shprehur se: Liria e shprehjes përbën një nga gurët themelorë të shtetit demokratik. Pa garantimin e kësaj të drejte nuk mund të bëhet fjalë për pluralizëm, tolerancë dhe krijim të vullnetit të lirë politik, aq të domosdoshëm për shoqërinë demokratike. Shkëmbimi i ideve dhe informimi i lirë janë ndër mjetet më të rëndësishme dhe më efikase për të kontrolluar demokracinë si formë e qeverisjes. Nëpërmjet tyre, pushteti shtetëror, bëhet më transparent, më efikas dhe më afër qytetarit. Liria e shprehjes është gjithashtu bazë dhe kusht i domosdoshëm paraprak për garantimin e një sërë të drejtave dhe lirive të tjera themelore. Për këtë arsye, zbatimi në praktikë i kësaj të drejte kërkon në çdo rast një kuptim dhe interpretim mjaft të gjerë...

Në Vendim i GJK 56/2016 GJK paraprakisht, vlerëson të ritheksojë se liria e shprehjes dhe e drejta e informimit, të parashikuara nga nenet 22 dhe 23 të Kushtetutës, përveç garancisë subjektive si të drejta kushtetuese themelore, janë të lidhura objektivisht edhe me parimin e ndërtimit të një shteti demokratik, të deklaruar në preambulën e Kushtetutës sonë. Zbatimi i këtij parimi të rëndësishëm nënkupton edhe garantimin e lirisë së shprehjes, të lirisë së shtypit dhe së drejtës së informimit, si të domosdoshme për një rend të lirë e kushtetues.

Parë në këndvështrimin e mësipërm, kjo Gjykatë i ka kushtuar vëmendje të posaçme lirisë së shprehjes, duke theksuar: *“Në dallim nga KEDNJ-ja, Kushtetuta jonë garanton lirinë e shprehjes në kuptim të ngushtë dhe të drejtën e informimit në dy dispozita të veçanta, respektivisht në nenet 22 dhe 23 të saj.*

- **A ka ndonjë ndryshim ndërmjet jurisprudencës së gjykatës suaj dhe jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte?**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka ndjekur dhe referuar jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte veçanërisht jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II.III E drejta e privatësisë/e drejta e respektimit të jetës private/e drejta e jetës private

- **Cili është formulimi origjinal i dispozitës që mbron këtë të drejtë në katalogun tuaj kombëtar?**

Neni 35 i Kushtetutës

1. Askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij.
2. Mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
3. Kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj.
4. Kushdo ka të drejtë të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

- **A është i mundur kufizimi i kësaj të drejte? Nëse po, si dhe në çfarë rrethanash?**

Në rastin e kufizimit të kësaj të drejte është ligjvënësi ai të cilit i takon që nëpërmjet ligjit të përcaktojë kriteret e kufizimit (si p.sh. kur një individ është i detyruar të bëjë publike të dhëna rreth tij siç mund të jetë në raste të një hetimi, kur e kërkon një interes i lartë publik, etj.)

- **A e ka marrë gjykata juaj në konsideratë këtë të drejtë/interpretimin apo mishërimin e saj në mënyrë më të detajuar? Nëse po, ju lutem jepni detaje praktike dhe listoni katalogët e aplikuar të të drejtave të njeriut.**

Gjykata Kushtetuese e ka trajtuar disa herë këtë të drejtë në vendimet e mëposhtme:

Në Vendim i GJK nr.2/2017, Gjykata, në një analizë të nenit 8 të KEDNJ-së, që lidhet me respektimin e jetës private, është shprehur se formulimi i nenit 8 evidenton jo vetëm detyrimin negativ të autoriteteve publike për të mos ndërhyrë në jetën private dhe familjare, por edhe detyrimin pozitiv shtetëror për t'i mbrojtur këto të drejta sa më realisht, përmes organeve të të tre pushteteve: ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor. Respektimi i jetës private kërkon, në parim, mosndërhyrjen në vendimet që merr vetë individi rreth mënyrës së bërjes së jetës së tij. Pa dyshim që, edhe në këtë rast, në parim, qëllimi i hartuesve të Kushtetutës ka qenë pikërisht garantimi i asaj hapësire të nevojshme brenda së cilës, individi, do të mund të zhvillonte në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Në çdo rast konkret, legjitimiteti ose jo i ndërhyrjes do të varej kryesisht nga intensiteti i saj, shkalla e cenimit të jetës private, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrjeje në shoqërinë demokratike dhe në realitetin konkret që e ka diktuar atë, efektiviteti dhe proporcionaliteti në raportin e qëllimit, që është synuar të arrihet dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. Mbi të gjitha, duhet pasur parasysh se sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime apo sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private. ...

Sipas nenit 17 të Kushtetutës, kufizime të të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen nëse përmbushen disa kushte: të vendosen me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve; duhet të jenë në përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar ato (parimi i proporcionalitetit/përpjestueshmërisë); të mos cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave; dhe në asnjë rast të mos tejkalojnë kufizimet e parashikuara nga KEDNJ-ja. Pra, kjo dispozitë kushtetuese kërkon vlerësimin e domosdoshmërisë së ndërhyrjes ligjore të shtetit, në varësi të natyrës së të drejtës, të karakterit të interesit publik që duhet të mbrohet, të rrethanave konkrete që e diktojnë një ndërhyrje në minimum dhe sa më pak të dëmshme nga pikëpamja e të drejtave të njeriut. GJEDNJ-ja është shprehur: “Sa herë që një shtet mundohet të mbështetet në parimin e “demokracisë së aftë të mbrojtë vetveten” në mënyrë që të justifikojë ndërhyrjen në të drejtat e njeriut, ai duhet të vlerësojë me shumë kujdes qëllimin dhe pasojat e masave që ndërmerr, për të siguruar arritjen e balancës së lartpërmendur” (*shih vendimin nr.9, datë 23.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në Vendim i GJK 52/2011, Gjykata vëren se ligji për gjendjen civile, nuk parashikon garanci për sa i përket marrjes, mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale “sensitive”. Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk i referohet, në mënyrë eksplicite dhe konkrete, ligjit për të dhënat personale. Në këtë aspekt, Gjykata e konsideron si thelbësore ekzistencën e një dispozite specifike referuese për shkak të natyrës “sensitive” të të dhënave mbi përkatësinë etnike. Gjykata vë në dukje se ligji për gjendjen civile nuk përmban as parashikime se si do të përdoren këto të dhëna apo mbi përgjegjësinë në rast keqpërdorimi të tyre, gjë e cila do të përbënte një garanci mjaft të rëndësishme për të gjithë shtetasit.

Nisur nga kjo premisë, Gjykata arrin në konkluzionin se, dispozitat e ligjit për gjendjen civile, objekt i këtij kontrolli kushtetues, duke vendosur detyrimin për regjistrimin e të dhënave mbi ‘kombësinë’ në regjistrat e gjendjes civile, ndërhyjnë në sferën e jetës private të individit, në kuptim të nenit 35 të Kushtetutës. Kjo ndërhyrje, në vlerësimin e Gjykatës, shkakton një devijim nga parimi kushtetues i mos-detyrimit të bërjes publike të të dhënave personale, ku përfshihen dhe të dhënat personale “sensitive”, i cili sanksionohet në nenin 35 të Kushtetutës. Gjykata çmon se mbrojtja e të dhënave “sensitive”, si një nga komponentët e së drejtës për respektimin e jetës private, garantohet nëpërmjet shprehjes së lirë të vullnetit për të bërë publike ose jo këto lloje të dhënash, në përputhje me nenin 35 të Kushtetutës. Të dhënat që sigurojnë informacion për analiza demografike, të nevojshme për zhvillim ekonomik dhe social apo për qëllime të politikave shtetërore për të nxitur ruajtjen e identitetit kulturor e gjuhësor të pakicave etnike, mund të merren nëpërmjet procedurave të tjera përkatëse, në përputhje me garancitë ligjore që parandalojnë shpërdorimin e të dhënave të mbledhura, si dhe përcaktojnë saktësisht rregullat e veçanta të përpunimit.

Në Vendim i GJK 16/2004, GJK është shprehur se:“.....Të dhënat mbi të ardhurat apo pasurinë kanë karakter personal. Për rrjedhojë, ato përfshihen në hapësirën e gjerë që mbron neni 35 i Kushtetutës. Si rregull, bërja e tyre publike, kërkon pëlqimin e vetë personit të interesuar.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje gjithashtu, se vetë neni 35 i Kushtetutës, krijon mundësinë e bërjes publike të të dhënave personale edhe pa pëlqimin e personit, nëse një gjë të tillë e “kërkon ligji” (paragrafi 1) ose në rastet e “parashikuara me ligj” (paragrafi 2). Një kufizim i tillë, në kushte të caktuara, gjen mbështetje edhe nga neni 17 i Kushtetutës (kufizimi të bëhet “...vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve...”). Gjithashtu GJK në këtë vendim thekson se: “publikimi i detajeve mbi të ardhurat ose pasurinë personale nuk përbën ndërhyrje në jetën private, veçanërisht nëse personi ushtron funksione publike ose *quasi*-publike”.

- **A ka ndonjë ndryshim ndërmjet jurisprudencës së gjykatës suaj dhe jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte?**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka ndjekur dhe referuar jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte si dhe është bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II.IV E drejta e besimit

- **Cili është formulimi origjinal i dispozitës që mbron këtë të drejtë në katalogun tuaj kombëtar?**

Neni 24 i Kushtetutës parashikon:

1. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë është e garantuar.
2. Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimimit, praktikave ose kryerjes së riteve.
3. Askush nuk mund të detyrohet ose të ndalohej të marrë pjesë në një bashkësi fetare ose në praktikat e saj, si dhe të bëjë publike bindjet ose besimin e tij.

- **A është i mundur kufizimi i kësaj të drejte? Nëse po, si dhe në çfarë rrethanash?**

Kushtetuta ka sanksionuar kritere të qarta se kur, si dhe për çfarë arsyesh justifikohet kufizimi i të drejtave themelore. Për një numër të caktuar të drejtash e lirish, është vetë Kushtetuta ajo që ka parashikuar, ndërsa për të tjerat, kushtetutë-bërësi ia ka deleguar këtë pushtet legjislatorit. Në këtë kontekst, një pjesë e mirë e dispozitave të të drejtave dhe lirive themelore në Kushtetutë parashikojnë klauzolën e rezervës ligjore. Ka edhe të drejta e liri kushtetuese të cilat, dispozita kushtetuese që i sanksionon nuk parashikon *prima facie* kufizim apo rezervë ligjore (p.sh. neni 24 liria e besimit). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se kjo e drejtë mund të ushtrohet në mënyrë absolute. Kjo e drejtë nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera, përveç atyre të parashikuara

nga ligji dhe që përbëjnë masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, të shëndetit ose të moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve.

- **A e ka marrë gjykata juaj në konsideratë këtë të drejtë/interpretimin apo mishërimin e saj në mënyrë më të detajuar? Nëse po, ju lutem jepni detaje praktike dhe listoni katalogët e aplikuar të të drejtave të njeriut.**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk e ka marrë në shqyrtim këtë të drejtë.

- **A ka ndonjë ndryshim ndërmjet jurisprudencës së gjykatës suaj dhe jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte?**

N/A

II.V Ndalimi i diskriminimit

- **Cili është formulimi origjinal i dispozitës që mbron këtë të drejtë në katalogun tuaj kombëtar?**

Neni 18 i Kushtetutës parashikon se:

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

- **A është i mundur kufizimi i kësaj të drejte? Nëse po, si dhe në çfarë rrethanash?**

E drejta për të mos u diskriminuar është një e drejtë që nuk mund të kufizohet, me përjashtim kur ajo parashikohet me ligj. Kështu Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për ndalimin e diskriminimit” në nenin 6 parashikon:

Trajtimi i ndryshëm i përligjur:

1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

2. Trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj.

Sipas Gjykatës: “Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masa për vënien në jetë të tyre, duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor. Nëse masat e marra shpien në përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës”.

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese i është referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke konkluduar se “dallimi në trajtim do të konsiderohet diskriminues, kur nuk ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, kur nuk ndjek një “qëllim të ligjshëm” ose kur nuk ekziston një “marrëdhënie e arsyeshme dhe përpjesëtimore ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet” (Vendimi nr. 23, datë 08.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese).

- **A e ka marrë gjykata juaj në konsideratë këtë të drejtë/interpretimin apo mishërimin e saj në mënyrë më të detajuar? Nëse po, ju lutem jepni detaje praktike dhe listoni katalogët e aplikuar të të drejtave të njeriut.**

Në Vendimin nr.10/2016, Gjykata, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Konkretisht, ajo është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.34, datë 20.12.2005; nr.39, datë 16.10.2007; nr.4, datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykata rikonsideron se organi ligjvënës është i detyruar t’i përmbahet këtij parimi kur bëhet fjalë për “barazinë në ligj”. Në lidhje me mos-diskriminimin, ajo ka përcaktuar disa standarde, me anë të të cilave ka synuar të vlerësojë nëse një ligj është diskriminues në termat e nenit 18 të Kushtetutës. Kështu, Gjykata shqyrton nëse ligji ka përcaktuar trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se po, a ka qenë diferencimi i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo

për ligji vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i për ligjur, por edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënës të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Nga ana tjetër, parimi i barazisë nuk e ndalon trajtimin e diferencuar, prandaj Gjykata, në rast trajtimi të njëjtë të subjekteve, shqyrton nëse ligji duhet të kishte pasur diferencim mbi një arsye legjitime dhe objektive, pasi ato (subjektet) paraqiten me specifika faktike të ndryshme.

Sipas praktikës së Gjykatës Kushtetuese, ndodhemi para diskriminimit, kur subjekte juridike që ndodhen në të njëjtën gjendje trajtohen në mënyrë të ndryshme pa justifikim ligjor të arsyeshëm dhe objektiv. Natyrisht që përkufizimi i çdo kriteri për ta cilësuar arsyetimin objektiv varet në një masë të madhe nga çmuarja e vlerave dhe nuk mund të jetë i përcaktuar në mënyrë precize (shih vendimet nr.71/1998; nr.16/2000 nr.34/2005; nr.39/2007; nr.4/2010; nr.48/2013; 78/2015 të Gjykatës Kushtetuese).

Në Vendimin nr.1/2013 GJK është shprehur se: Kuvendi i Shqipërisë, pas ndryshimeve demokratike, miratoi një tërësi ligjesh, me synimin e riparimit të padrejtësive të trashëguara nga regjimi i mëparshëm, lidhur me garantimin e të drejtave dhe lirive themelore, veçanërisht, të së drejtës për pronë private. Fillesat e kuadrit ligjor janë ligjet nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe nr.7698, datë 15.04.1993 “Për rikthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Qiramarrësit, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara, pretendonin se rregullimet ligjore ishin diskriminuese. Megjithatë, pas kontrollit të pajtueshmërisë së këtyre ligjeve me Kushtetutën, Gjykata arriti në përfundimin se rregullimet ligjore nuk i diskriminonin qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuara, në raport me pjesën tjetër të popullsisë që e realizoi nevojën për strehim në bazë të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” (i ndryshuar), pasi zgjidhja e ndryshme e problemeve të strehimit që kanë këto kategori qiramarrësish nuk vjen për shkak të ndonjë diskriminimi që bëhet ndërmjet tyre, por për shkak të pozitave të ndryshme që kanë ata në fakt, të parët si qiramarrës të banesave të ndërtuara nga shteti, të dytët si qiramarrës të banesave që u kthehen ish-pronarëve (shih vendimin nr.11, datë 27.08.1993 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjk është shprehur në jurisprudencën e saj se: “Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendjeje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit, askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një për ligji e arsyeshme dhe objektive (shih vendimin nr. 48, datë 15.11.2013; Vendim nr. 60/2016 të Gjykatës Kushtetuese)”.

Gjykata Kushtetuese në lidhje me mbrojtjen e këtyre të drejtave është mbështetur në KEDNJ

- **A ka ndonjë ndryshim ndërmjet jurisprudencës së gjykatës suaj dhe jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte?**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka ndjekur dhe referuar jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte si dhe është bazuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

II.VI E drejta e lirisë

- **Cili është formulimi origjinal i dispozitës që mbron këtë të drejtë në katalogun tuaj kombëtar?**

Neni 27 i Kushtetutës

1. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj.

2. Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë; dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

3. Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor.

- **A është i mundur kufizimi i kësaj të drejte? Nëse po, si dhe në çfarë rrethanash?**

Rastet e kufizimit të kësaj të drejte janë të parashikuara në nenin 27 të Kushtetutës dhe për këtë arsye nuk mund të kufizohen me ligj. Ato janë:

a) kur është dënuar me burgim nga gjykata kompetente; b) për moszbatim të urdhrave të ligjshëm të gjykatës ose për moszbatim të ndonjë detyrimi të caktuar me ligj; c) kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; ç) për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij në organin kompetent; d) kur personi është përhapës i një sëmundjeje ngjitëse, i paaftë mendërisht dhe i rrezikshëm për shoqërinë; dh) për hyrje të paligjshme në kufirin shtetëror, si dhe në rastet e dëbimit ose të ekstradimit.

- **A e ka marrë gjykata juaj në konsideratë këtë të drejtë/interpretimin apo mishërimin e saj në mënyrë më të detajuar? Nëse po, ju lutem jepni detaje praktike dhe listoni katalogët e aplikuar të të drejtave të njeriut.**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë nuk e ka marrë në shqyrtim këtë të drejtë.

- **A ka ndonjë ndryshim ndërmjet jurisprudencës së gjykatës suaj dhe jurisprudencës së gjykatave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e kësaj të drejte?**

N/A